



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr.872/ 21

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, nenin 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Ardi shpk” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Furnizim me teste te shpejta antigjen përmes pështymës për Covid 19” me nr. prokurimi “ 616-21-9891-1-1-5”, iniciuar nga AK - Komuna e Prishtinës , Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 20 janar 2022 mori këtë :

VENDIM

- I. **Hedhet si e pa lejuar** ankesa e OE “Ardi shpk” për aktivitetin e prokurimit me titull “ Furnizim me teste te shpejta antigjen përmes pështymës për Covid 19” me nr prokurimi “ 616-21-9891-1-1-5, iniciuar nga AK - Komuna e Prishtinës.
- II. **I LEJOHET** autoritetit kontraktues – Komunës së Prishtinës që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit me titull “ Furnizim me teste te shpejta antigjen përmes pështymës per Covid 19” me nr prokurimi “ 616-21-9891-1-1-5” (përkritazi me këtë ankese nëse nuk ka ankese tjetër)

- III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i deponitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 28.12.2021 , ka pranuar ankesë nga O “Ardi ShPK” për aktivitetin e prokurimit me titull “ Furnizim me teste te shpejta antigjen përmes pështymës për Covid 19” me nr. prokurimi “ 616-21-9891-1-1-5”, aktivitet ky I iniciuar nga AK - Komuna e Prishtinës , ankesë kjo e protokolluar me numër të protokollit 872/21.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se për aktivitetin e prokurimit në fjalë , Njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe Letra standarde është publikuar me datë: 07.12.2021 ne ora 14:36h.

Kërkesa për rishqyrtim nga OE ankues është dërguar me dt.16.12.2021 ne ora 11: 35h ne ditën e 9 kalendarike pas publikimit te njoftimit për kontrate.

AK KK Prishtinë me datën 17.12.2021 ne ora 08:30h merr vendim lidhur me kërkesë për rishqyrtim duke e hedhur si të palejuar kërkesën për rishqyrtim.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstaton se nga provat e prezantuara vërehet se OE ankues ka humbur afatin ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim sepse autoriteti kontraktues me datë: 07.12.2021 në ora 14:36h, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe Letra standarde, kurse OE ankues kërkesën për rishqyrtim e ka dërguar me datë: 16.12.2021 në ora 11: 35h në ditën e nëntë (9) kalendarike pas publikimit te njoftimit për kontrate dhe Letrës standarde.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se paragrafin 3 të nenit 108A i Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave specifikon:

- a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.
- b) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.
- c) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

Prandaj duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lart OSHP konstaton se ankesa e parashtruar në OSHP nga OE: “Ardi shpk” e datës 28.12.2021, me numër te protokollit 872/21, e parashtruar kundër aktivitetit te prokurimit me titull “Furnizim me teste te shpejta antigjen përmes pështymës për Covid 19” me nr. prokurimi “ 616-21-9891-1-1-5, iniciuar nga AK Komuna e Prishtinës, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi kërkesën për rishqyrtim e ka parashtruar në kundërshtim me nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik dhe nenit 4 i “Rregullave Rregullat e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pran autoriteti kontraktues, parashtrimi të ankesave pran OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta ankesë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Prishtinës

1x1 OE “Ardi” shpk

1x1 Arhivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së

